



Agjencia e Doganave dhe Monopoleve: Italia dhe Shqipëria intensifikojnë bashkëpunimin doganor.

Drejtori i Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve Roberto Alesse dhe Komandanti i Përgjithshëm i Policisë Financiare Andrea De Gennaro takuan në Romë Drejtorin e Administratës Doganore Shqiptare Genti Gazheli, me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në çështjet e doganave.

Në vazhden e aktiviteteve të filluara me marrëveshjet dypalëshe për ndihmën e ndërsjellë, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin administrativ, të nënshkruara përkatësisht në vitet 1998, 2003 dhe 2022 u vendos të intensifikohen më tej përpjekjet e përbashkëta për të garantuar ligjshmërinë dhe sigurinë në aktivitetet tregtare ndërkufitare.

Angazhimi i parë do të synojë vlerësimin e çdo përditësimi të nevojshëm të marrëveshjeve ekzistuese, me qëllim nxitjen e afrimit të doganave shqiptare me standardet evropiane në fushën e kontrollit dhe parandalimit të mashtrimit.

Tre administratat gjithashtu kanë rënë dakord të fillojnë shkëmbimin e përvojave dhe aktiviteteve të formimit midis porteve të Ankonës, Barit dhe Brindizit dhe ato shqiptare të Durrësit dhe Vlorës. Këto nisma do të financhen edhe falë fondeve të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) në kuadër të programit të unionit *Adriacustoms*.

Policia Financiare, e cila ndodhet prej 25 vitesh në Shqipëri me një mision bashkëpunimi për të parandaluar trafikun e paligjshëm nga deti, do të forcojë nismat në sektorin e doganave nëpërmjet ndihmës së ekspertit të saj me detyrë në Ambasadën në Tiranë.

Sinergjia ndërmjet Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve dhe Policisë Financiare, mbështetet nga Memorandumi i Mirëkuptimit i firmosur prillin e kaluar.